



ZYRA E KUVENDIT TË KOMUNËS
Sektori Ligjor dhe për punë të Kuvendit
01-Nr- _____
Me datën 09.12.2021

PLANII PUNES SË KUVENDIT TE KOMUNËS SË SUHAREKËS PËR VITIN 2023

Kuvendi i Komunës është organi me i larte në Komunë dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetaret, dhe funksionon ne baze te Ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutit dhe akteve Ligjore dhe nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Kuvendi i Komunës siguron kushte te punës për mbajtje te seancave te Kuvendit te Komunës, si dhe pjesëmarrje për qytetare gjate seancave. Siguron transparence te plote ndaj qytetareve për te gjitha vendimet dhe aktet tjera, si dhe për çdo gjë që është ne interes te qytetareve. Po ashtu, i'u krijon mundësi qytetareve qe përmes formave te ndryshme te jene pjesëmarrës ne proceset vendimmarrëse.

Plani i Punës se Kuvendit te Komunës se Suharekës është dokument i mbështetur ne Ligjin për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren e Punës se Kuvendit dhe aktet tjera Ligjore dhe nënligjore. Plani është i hartuar ne baze te një kornize logjike i cili planifikon etapat e realizimit te punëve dhe detyrave te Kuvendit te bazuara ne detyrat dhe përgjegjësitë qe dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale, Statuti dhe aktet tjera primare dhe sekondare.

Me këtë plan synohet arritja e objektivave për vitin 2023, ku Kuvendi i Komunës se Suharekës, planifikon t'i mbaj 12, (dymbëdhjetë) seanca te rregullta, 6 (gjashtë) prej te cilave ne (6) gjashtëmujorin e pare te vitit 2023, ne te cilat do te trajtohen te gjitha çështjet qe janë ne interes te Komunës dhe te qytetareve te Suharekës, e te cilat janë te proceduara sipas akteve Ligjore dhe nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Plani vjetor i punës se Kuvendit te Komunës, do te ndihmoje dhe lehtësoje punimet e mbledhjeve te Kuvendit, duke iu ofruar anëtareve te Kuvendit këtë plan, ata do te kenë një pasqyre për punët dhe aktivitetet e parapara për vitin 2023 e qe kane te bëjnë me interesat e qytetareve.

Përveç këtyre temave të cekura më poshtë, Kuvendi i Komunës së Suharekës, do të shqyrtoj dhe miraton edhe tema apo çështje tjera të cilat janë me rëndësi dhe në interes për qytetarët dhe Komunën e Suharekës.

Planifikimi i planit të punës i Kuvendit të Komunës në Suharekë për vitin 2023.

Janar	1. Miratimi i Statutit të Bibliotekës së qytetit “Hajdin Berisha” në Suharekë 2. Miratimi i vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit me numër 01-Nr-16-4813 të datës 27.06.2013 3. Informatë për aktivitetet e KKS-së për periudhën korrik-dhjetor të vitit 2022; 4. Formimi komisioni përzgjedhës për intervistimin dhe vlerësimin e kandidatëve që kanë konkurruar në pozitat e drejtorëve dhe zëvendësrejtoreve për vitin shkollor 2022/2023	Aktivitetet
Shkurt	1. Njoftimi i planit të prokurimit për vitin 2023; 2. Raport pune për zyrën e prokurimit për vitin 2022; 3. Inicimi i procedurës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës; 4. Miratimi i vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm	
Mars	1. Raporti përfundimtar financiar për vitin 2022; 2. Bartja e mjeteve vetanake të vitit 2022 për shfrytëzim në vitin 2023; 3. Miratimi i raportit të punës dhe aktiviteteve të Komisionit Komunal të aksionarëve për NPL “Stacioni i Autobusëve” në Suharekë për vitin 2022; 4. Raport i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2022; 5. Themelimi komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës	
Prill	1. Informatë e Kryetarit mbi gjendjen ekonomike financiare për 3 (tre) mujorin e parë të vitit 2023; 2. Raportimi për dhunën në familje; 3. Dhënia e pëlqimit për iniciimin e procedurave për hartimin e planit rregullues për zonën industriale në “Biraq”; 4. Plotësim-Ndryshimi i Rregullores për Menaxhimin e mbeturinave;	
Maj	1. Vendimi për ndarjen e shpërblimeve për nder të “13 Qershorit” ditës së çlirimit të Suharekës me rrethin; 2. Miratimi i raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim afat gjatë pronës së paluajtshme të Komunës; 3. Inicimi i procedurës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës; 4. Miratimi i vendimit për caktimin e vlerës së bonus banimit	
Qershor	1. Miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (2024-2026); 2. Rishikimi i buxhetit për vitin 2023; 3. Miratimi i Planit për Menaxhimin e Parkingjeve; 4. Miratimi i raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronës së paluajtshme të Komunës; 5. Themelimi komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;	
Korrik	1. Konsultimi publikut dhe pjesëmarrja e publikut në vendim marrje; 2. Informatë e Kryetarit mbi gjendjen ekonomike financiare për 6 (gjashtë) mujorin e parë të vitit 2023; 3. Informatë për aktivitetet e KKS-së për periudhën Janar-Qershor të vitit 2023; 4. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Jashtëm për vitin 2022;	
Gusht	1. Dëgjimet publike për planifikimin e buxhetit për vitin 2024; 2. Miratimi i Rregullores për taksa komunale;	

	3. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të ZKA-së; 4. Shqyrtimi i raportit të performancës së Komunës për vitin 2022;	
Shtator	1. Miratimi i Buxhetit dhe Plani i Investimeve për vitin 2024; 2. Shqyrtimi i Raportit të auditorit të brendshëm për vitin 2022; 3. Miratimi i vendimit për ndarjen e çmimit “Ukë Bytyçi”;	
Tetor	1. Informate e Kryetarit mbi gjendjen ekonomike financiare për 9 (nëntë) mujorin e parë të vitit 2023; 2. Rregulloren për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në Komunën e Suharekës; 3. Inicimi i procedurës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës;	
Nëntor	1. Miratimi i planit të veprimit për transparencën për komunën e Suharekës për periudhën 2024-2027 ; 2. Diskutim për sensibilizimin e qytetarëve kundër dhunës në familje; 3. Miratimi i raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronës së paluajtshme të Komunës; 4. Themelimi i komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;	
Dhjetor	1. Planifikim i punës së Kuvendit dhe orari i mbledhjeve të KPF-së dhe Kuvendit të Komunës së Suharekës, për vitin 2024; 2. Miratimi i planit vjetor të punës të këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2024; 3. Raporti për zbatimin dhe monitorimin e PZHK-së 4. Raporti për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së	

Përveç këtyre temave në Kuvendin e Komunës së Suharekës, do të shqyrtohen edhe tema tjera të cilat janë me rëndësi dhe në interes për qytetarët dhe Komunën e Suharekës.